REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 149/17
Datë/Datum. 04.07.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW

PSH. Nr. 149/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, në përbërje prej: z. Nuhi Paqarizi - Kryetar, z. Blerim Dina – Referues, z. Goran Milenkovic - anëtar duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE **"AB Clean"** - Lipjan, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Shërbimet e pastrimit dhe mirëmbajtjes së objekteve komunale, shëndetësore dhe arsimore"**, me numër të prokurimit: 657/17/983/221, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komuna Viti**, më: 28.06.2017, mori këtë :

VENDIM

I. **Aprovohet**, pjesërisht ankesa e OE **"AB Clean"** - Lipjan, lidhur me procedurën e prokurimit me titull: **"Shërbimet e pastrimit dhe mirëmbajtjes së objekteve komunale, shëndetësore dhe arsimore"**, me numër të prokurimit: 657/17/983/221, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komuna Viti**.

II. **Anulohet,** vendimi i autoritetit kontraktues **Ministria e Administratës Publike**, lidhur me procedurën e prokurimit me titull: **"Shërbimet e pastrimit dhe mirëmbajtjes së objekteve komunale, shëndetësore dhe arsimore"**, me numër të prokurimit: 657/17/983/221, si i pa bazuar dhe lënda kthehet në **Ri-vlerësim**.

III. **Urdhërohet**, autoritetit kontraktues **Komuna Viti**, që procedurën e prokurimit me titull **"Shërbimet e pastrimit dhe mirëmbajtjes së objekteve komunale, shëndetësore dhe arsimore"**, me numër të prokurimit: 657/17/983/221, ta kthej në Ri-vlerësim dhe mos respektimi i këtij vendimi e detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore nenit 131 të LPP-së nr. 04/L-042, të ndërmarr masa ndaj autoritetit kontraktues.

IV. Meqenëse pretendimet ankimore të operatorit ekonomik ankues "AB Clean" - Lipjan janë pjesërisht të qëndrueshme, konform nenit 118 të LPP-së, i kthehet sigurimi i ankesës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë është bërë me dt: 24.03.2017, ndërsa hapja e ofertave është bërë me dt: 12.04.2017, ndërsa në këtë aktivitet të prokurimit kanë marr pjesë gjashtë operatorë ekonomik.

Njoftimi për dhënie të kontratës është bërë me dt: 05.05.2017, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik "Saf" – Prishtinë.

Kërkesa për rishqyrtim nga ana e operatorit ekonomik "AB Clean" - Lipjan, është bërë konform nenit 108/A te LPP-se. Vendimi në lidhje me kërkesën për rishqyrtim ku është marr brenda afatit te paraparë me ligj.

Operatori ekonomik "AB Clean" - Lipjan, si palë e pakënaqur ka deponuar ankesë në OSHP më 22.05.2017, me nr. të protokollit, 149/17, kundër njoftimit për dhënie të kontratës të OE "Saf", duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të LPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 të LPP-së nr. 04/L-042, ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të shqyrtuar procedurën e zhvilluar lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, si dhe vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues, në raportin e datës: 05.06.2017, ka konstatuar se AK-ja, nuk i ka respektuar ne tërësi dispozitat e LPP-së, duke sqaruar ne vijim se lidhur me librezën e automjetit AK-ja, ka mundur qe konform nenit 72 te LPP-se te kërkoj sqarime lidhur me atë dokument. Poashtu lidhur me mos nënshkrimin e specifikave teknike, eksperti shqyrtues ka sqaruar se nuk është i qëndrueshëm ky arsyetim i AK-se, për eliminim te operatorit ekonomik, për faktin se, te specifikimet teknike janë dhënë vendet/objektet ku do të bëhet mirëmbajtja dhe një pjesë e vogël është me furnizim. Prandaj, eksperti shqyrtues, duke u bazuar në sqarimet e dhëna në raport të ekspertizës i ka propozuar panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe njëherit i ka propozuar panelit shqyrtues që ky aktivitet i prokurimit te kthehet ne Ri-Vlerësim.

OE ankues "AB Clean" - Lipjan përmes parashtresës, ka deklaruar se pajtohet me mendimin dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues të dhënë në raportin e datës 05.06.2017.

Poashtu, AK-ja, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me raportin dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues, për këtë aktivitet të prokurimit.

Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor, më 28.06.2017, ne te cilën ishin prezent anëtarët e Panelit shqyrtues, eksperti shqyrtues, përfaqësuesi i autorizuar OE ankues si dhe përfaqësuesi i AK-së. Në seancë u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, përgjigjja e AK-së mbi raportin e ekspertizës si dhe parashtresa e OE ankues lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Gjatë prezantimit në seancë, përfaqësuesja e autorizuar e OE ankues znj.Brestovci deklaroj: Pika 3 ekspertizës ka qenë për dokumentet për automjetin Pickup, të cilin AK-ja, e din mirë që ne e posedojmë pasi ne kemi punuar një vit pranë AK- Komunës së Vitisë.
Çështja tjetër është që jam shumë e sigurt se libreza automjetit ka qenë në ofertë dhe përfaqësuesi i AK-se, shumë mirë e dinë që ai dokument ka qenë, e ku ka mbet nuk dimë mirëpo mund të verifikojmë këtë duke hapur kopjen e dosjes. Po ashtu sipas LPP-së ka pas drejtë të kërkojë si dokument shtesë dhe nuk është arsye për eliminimin.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së, z. Abazi deklaroj se: AK – Komuna Viti nuk është pajtuar me ekspertizën e ekspertit nr.149/17, që ka të bëjë me dy pika që ne kemi refuzuar dhe e kemi eliminuar OE ankues.

Pika parë për cilën mendojmë se është relevante të cilën e eksperti e tejkalon duke mos pa rëndësinë e saj, ne në këtë pikë që është specifikim teknik i detyrueshëm, pasi këto janë shërbime shumë komplekse me cilat vazhdimisht kemi probleme në zbatim të kontratës për te cilën është në njohuri edhe OE ankues pasi ka kontratë për vitin e kaluar. Gjithë problemi është te numri i punëtorëve dhe tek pagat.

Nëse ne në specifika nuk përcaktojmë një minimum të punëtorëve dhe minimum të pagës atëherë japim mundësi të vlerësimit të lirë të OE për të dhënë një ofertë të cilën pastaj do negociojnë me ne. Ne kemi sipërfaqe prej 12.6000 metra katrorë me cilën e pastrojmë ditë të tëra 30 punëtor. Nëse nuk vendosim këtë kriter atëherë OE në mënyrë diskriminuese mund ti përdor punëtorët, andaj kemi parë normën për numër dhe pagë minimale.

Ne kemi pas njëjtin problem me po këtë kompani në zbatim të kontratës pikërisht për këto çështje. OE ankues nuk ka vulos dhe nuk ka pranuar këto specifika teknike të detyrueshme. OE vitin e kaluar e ka raportin negativ për vitin e kaluar. OE nuk i ka pranuar këto kushte, nuk i ka vulosur pasi ka pas dështim në këto pika vitin e kaluar. Sa i përket automjetit PickUp, mungon libreza e automjetit, dhe jemi të pajtimit që mund të hapet kopja për të vërtetuar ekzistencën e saj.

Në vazhdim fjala iu dha ekspertit shqyrtues të prokurimit z.Basha deklaroj: Arsye e parë e eliminimit, në dosje të tenderi tek aneksi 1 AK-ja, nuk ka vendos specifikime teknike, ka vendos një tabelë ku janë cekur vendet ku duhet te pastrohet dhe disa nga furnizimet e pastrimit-materiali i nevojshëm, andaj në vlerësim tim këto nuk janë specifika teknike.

Arsyeja e dytë e eliminimit për dëshmi apo librezën e automjetit që e ka kërkuar AK-ja, OE ankues nuk ka dorëzuar dëshmi lidhur me automjetin, përveç se ka një deklaratë dhe foto të automjetit. Në dosje AK-ja, ka kërkuar librezën e automjetit si dëshmi. Mirëpo për shkak çmimit më të ulët kam propozuar që ky dokument të verifikohet apo te kërkohet nga OE ankues.

Në fund përfaqësuesi i OEankues, znj,brestovci deklaroj: nuk qëndron se janë angazhuar për ato hapësira 30 punëtor, janë 20 dhe kjo pasi ai është numri aktual që e kemi gjetë pranë AK-së. Raport negativ neve për asnjë vit nuk na është lëshuar pasi çdo muaj është bërë pagesa. Raporti negativ në pjesën e aneks kontratës nuk ka efekt juridik. I propozojmë panelit të aprovoj ankesën dhe lëndën ta kthej në rivlerësim.

Në fund përfaqësuesi i AK-së, z.Abazi deklaroj: AK-ja, ka vendos kritere për 30 punëtor në pjesë ku janë obliguese të plotësohet- ose nënshkruhet nga OE-te, dhe OE ankues nuk e ka vulosur këtë

pjesë të dosjes. I propozoj panelit shqyrtues që të refuzoj ankesën e OE ankues dhe të lejoj AK-në të vazhdoj më tutje me këtë aktivitet të prokurimit gjegjësisht me dhënie të kontratës.

Në fund z.Basha deklaroj: Qëndroj pranë raportit të ekspertizës nr.149/17.

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, raportit të vlerësimit të komisionit vlerësues të AK-së, shqyrtimit të pikave pretenduese të parashtruesit të ankesës, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues të cekur në ekspertizë, parashtresës së OE ankues, parashtresës së AK-së, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, konstaton dhe vlerëson se është i qëndrueshëm pretendimi i OE ankues se AK-ja padrejtësisht na ka eliminuar lidhur me kërkesën e dosjes së tenderit për dëshminë e automjetit për faktin se AK-ja, konform nenit 72 të LPP-së, mund të kërkoj sqarime shtesë lidhur me atë dëshmi për faktin se ky dokument nëse ekziston atëher data e atij dokumenti duhet të jet e fiksuar përpara hapjes se ofertave, në rast të kundërt Operatori ekonomik eliminohet si i papërgjegjshëm.

Paneli shqyrtues, lidhur me mos nënshkrimin dhe vulosjen e specifikimeve teknike, sqaron se në një pike të saj AK-Komuna e Vitisë, ka kërkuar një numër të caktuar të punëtorëve dhe gjithashtu për këta punëtor ka kërkuar edhe një pagë të caktuar, për të cilën në bazë të shkresave të lëndës rezulton se AK-ja, nuk e ka vlerësuar fare. Andaj, Paneli shqyrtues, e obligon AK-në, që gjatë fazës së Ri-vlerësimit të marr parasysh të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit duke përfshirë këtu edhe kalkulimin e pagës në raport me numrin e punëtorëve dhe çmimeve të ofruara.

Prandaj Paneli shqyrtues, duke u bazuar në nenin 117 të LPP-së, si dhe duke u mbështetur në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike :
Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur
nuk mund të ushtron ankesë,
por për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh,
pas pranimit të këtij vendimi, mund të ngritë
kërkesë-padi në Gjykatën Themelore - Prishtinë
Departamenti për Çështje Administrative.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Nuhi Paqarizi

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK –Komunës së Vitisë

1x1 OE "AB Clean"

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.